



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
SHQYRTUES I PROKURIMIT / Telo za Razmatranje Nabavke

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

Nr./Bë. 596/20  
Datë/Datum. 18.09.20

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

PRISHTINE - PRISTINA



**PSH .nr. 596/20**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “BUSHGEGU 89” - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “AOME” SH.P.K-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me dru për ngrohje”, me nr. të prokurimit: VU644-20-2120-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Vushtrrisë, më datën: 17.09.2020, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “BUSHGEGU 89” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me dru për ngrohje”, me nr. të prokurimit: VU644-20-2120-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Vushtrrisë.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me dru për ngrohje”, me nr. të prokurimit: VU644-20-2120-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Vushtrrisë, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N. “BUSHGEGU 89” - Prishtinë, aprovet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

**VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.**

## **A R S Y E T I M**

Operatori ekonomik ankues OE "BUSHGEGU 89" - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 26.08.2020 me nr. 596/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me dru për ngrohje", me nr. të prokurimit: VU644-20-2120-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Vushtrisë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1 dhe 2, 7, 59, 64, 65, 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 4 të RRUOPP-së pika 4.4 .

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 31.08.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 04.09.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

**Pretendimi nr. 1,** Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, është njoftuar nga AK-Komuna Vushtri si tenderues i pasuksesshëm, ndërsa në ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, pretendon se i rekomanduari për kontratë nuk e plotëson kërkesën e AK-se, lidhur me kontratë dhe referencë të furnizimeve të njëjta, në vlerë prej 160,000.00€.

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë pretendim sqaron se i rekomanduari për kontratë ka ofruar listën e kontratave për furnizim me dru në vlerë prej: 118.808.40€.

Po ashtu OE i rekomanduar për kontratë, ka ofruar edhe një listë tjetër për furnizim me pelet në vlerë prej: 64,591.90€.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë ku AK-ja, ka kërkuar kontratë të furnizimeve të njëjta dhe njëherit duke u bazuar në listën e ofruar nga i rekomanduari për kontratë, vlerëson se i njëjti nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, lidhur me kontratat dhe referencat. Eksperti shqyrtues, vlerëson se ky pretendim është i qëndrueshëm.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se, i rekomanduari për kontratë nuk e plotëson kërkesën e AK-se lidhur



me vërtetimin e Agjencionit Pyjor të Kosovës se për të njëjtin nuk ka të ngritur ndonjë procedurë për dëme pyjore dhe se nuk ka obligime të pashlyera, duke pretenduar se data e lëshimit të këtij dokumenti është 15.05.2020 (5 dite para publikimit të njoftimit për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit), ndërsa kompanisë tona i është kërkuar vërtetimi me datën: 17.07.2020, andaj pretendon se është diskriminuar si operator ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

Eksperti shqyrtues, fillimisht sqaron se vërtetimi i lëshuar nga Agjensioni Pyjor i Kosovës, për operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë mban datën: 15.05.2020.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit sqaron se AK-ja, nuk ka vendosur afat të caktuar se sa duhet të jetë me i vjetër ky dokument. AK-ja, me datën: 28.07.2020, përmes email-it, i është drejtuar me shkrim OE të rekomanduar për kontratë nga i cili e ka kërkuar vërtetimin e APK-se. I njëjti në përgjigje të kërkesës së AK-se e ka dorëzuar të njëjtën dëshmi që e ka dorëzuar me ofertë (te datës: 15.05.2020).

AK-ja, me datën: 11.08.2020 i është drejtuar me shkrim organit kompetent për verifikim të vërtetimit të APK-se, të cilët në përgjigje kanë deklaruar se për OE të rekomanduar për kontratë për shkak të parregullsive të konstatuara nga inspektorët përkatës, për të njëjtin ka procedurë të iniciuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Andaj, eksperti shqyrtues në bazë të dëshmive vlerëson se bie ndesh me kërkesën e dosjes së tenderit dhe njëherit vlerësoj se ky pretendim i OE ankues qëndron.

**Mendimi i ekspertit shqyrtues:** Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 04.09.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se Pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 05.09.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se Pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 17.09.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit

të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrirat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

pretendimeve të palës ankimore, dhe se OE ankues, është njoftuar nga AK-Komuna Vushtrri si tenderues i pasuksesshëm, ndërsa në ankesën e tij ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se i rekomanduari për kontratë nuk e plotëson kërkesën e AK-së, lidhur me kontratë dhe referencat të furnizimeve të njëjta, në vlerë prej 160,000.00€.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit konstaton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar listën e kontratave për furnizim me dru në vlerë prej: 118.808.40€.

Po ashtu OE i rekomanduar për kontratë, ka ofruar edhe një listë tjetër për furnizim me pelet në vlerë prej: 64,591.90€. Duke u bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë ku AK-ja, ka kërkuar kontratë të furnizimeve të njëjta dhe njëherit duke u bazuar në listën e ofruar nga i rekomanduari për kontratë, konstatohet se i njëjti nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, lidhur me kontratat dhe referencat. Eksperti shqyrtues, vlerëson se ky pretendim është i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se i rekomanduari për kontratë nuk e plotëson kërkesën e AK-së lidhur me vërtetimin e *Agjencionit Pyjor të Kosovës* se për të njëjtin nuk ka të ngritur ndonjë procedurë për dëme pyjore dhe se nuk ka obligime të pashlyera, duke pretenduar se data e lëshimit të këtij dokumenti është 15.05.2020 (5 ditë para publikimit të njoftimit për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit), ndërsa kompanisë tone i është kërkuar vërtetimi me datën: 17.07.2020, andaj pretendon se është diskriminuar si operator ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues, konstaton se vërtetimi i lëshuar nga Agjensioni Pyjor i Kosovës, për operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë mban datën: 15.05.2020. Duke u bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit sqarohet se AK-ja, nuk ka vendosur afat të caktuar se sa duhet të jetë me i vjetër ky dokument. AK-ja, me datën: 28.07.2020, përmes email-it, i është drejtuar me shkrim OE të rekomanduar për kontratë nga i cili e ka kërkuar vërtetimin e APK-së. I njëjti në përgjigje të kërkesës së AK-së e ka dorëzuar të njëjtën dëshmi që e ka dorëzuar me ofertë (të datës: 15.05.2020).



Po ashtu sqarojmë, se AK-ja, me datën: 11.08.2020 i është drejtuar me shkrim organit kompetent për verifikim të vërtetimit të APK-se, të cilët në përgjigje kanë deklaruar se për OE të rekomanduar për kontratë për shkak të parregullsive të konstatuara nga inspektorët përkatës, për të njëjtin ka procedurë të iniciuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Andaj, nga të cekurat si më lart Paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit AK duhet të kërkojë sqarime shtese për dokumentet e kontestuar nga ankuesi për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës në mënyrë që të vërtetohet se OE në fjalë a plotëson apo jo kërkesën e AK-së, për Vërtetimin e APK-se.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së. Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues  
Nuhi PAÇARIZI



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK - "KK Vushtrri"
- 1x1 OE - "BUSHGEGU 89" - Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.